



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
**MINISTRIA E INTEGRIMIT
EUROPIAN**

Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshë takon z. Christian Danielsson

2017-05-19 14:39:00



Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshë, priti sot në një takim z. Christian Danielsson, Drejtor i Zgjerimit në Komisionin European.

Ministrja Gjoshë: Shqipërisë duhet t'i jepet shansi sa më parë për çeljen e negociatave

Ministrja e Integrimit European, znj. Klajda Gjoshë, priti sot në një takim z. Christian Danielsson, Drejtor i Zgjerimit në Komisionin European.

Bashkëbiseduesit, diskutuan lidhur me zgjedhjet e ardhshme parlamentare, duke përshëndetur marrëveshjen e arritur pas së cilës i hapet rruga zbatimit të ligjit të vettingut, i cili mbetet kyç për çeljen e negociatave me Bashkimin European.

Ministrja Gjoshë u shpreh se qytetarët shqiptarë meritojnë që procesi i integrimit të bëjë hapa përpara, duke nënvizuar se çdo pengesë e deri tanishme ka qenë pengesë edhe për këtë proces.

“Ne presim që sa më shpejt të kemi rezultatet e para për ligjin e vettingut, në mënyrë që Shqipëria të hapë negociatat. Kjo fazë e procesit është shumë e rëndësishme për vendin, ndaj edhe angazhimi ynë mbetet maksimal për të përmbushur të gjitha detyrimet që vendi ka për të hedhur këtë hap dhe Shqipërisë t'i jepet ky shans”, tha Ministrja Gjoshë.